



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272567

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06326442

C-III.-12-1175

Paditësi:

I A– fshati S e Ç, K Viti

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë,

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Hajrie Shala gjyqtare kryesuese dhe gjyqtarët Bajram Miftari e Diellza Hoxha anëtarë, me dt.04 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit I A.

2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt. 17.07.2012 paditësi ka ushtruar padi për njohje të së drejtës së pronës –parcelës me sipërfaqe prej 1 (një) hektar e 75(shtatëdhjetë) e 5(pesë) ari, në vendin e quajtur “M“ S e E, ZK S e E si pasuri e Shoqërore e Agromoravës , duke konsideruar se është pronar i kësaj parcele sipas Aktvendimit 10515/47 nr.116244/47. Në padi ka kërkuar që të obligohet Agjencioni

Kosovar i Privatizimit mos ta tenderoj as shes pronën për të cilën është pronar i vetëm dhe trashëgimtar i gjyshit të tij N A .

Gjykata ka caktuar seancën dëgjimore me dt. 04.10.2024 por, në ftesën e dërguar paditësit për seancë, me dt. 18 dhe 26 shtator 2024 nga shërbimi postar është dhënë konstatimi se I A ka vdekur .

Andaj, në seancë ka prezantuar vetëm përfaqësuesi i palës së paditur AKP me autorizim G A ndërsa, për paditësin nuk ka prezantuar askush dhe gjykata ka lexuar konstatimet e dhëna në fletëkthesë.

Me këtë rast në mungesë të palës paditëse gjykata morri Aktvendim dhe vendosi që të ndërprehet procedura.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit I A

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse, sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.”*

Në kuptim të këtyre dispozitave Gjykata, në seancën e caktuar dhe mbajtur në prezencën e palës së paditur mori vendim që procedura të ndërprehet.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese _____

Bajram Miftari , Gjyqtar _____

Djellza Hoxha , Gjyqtare _____